



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.07.2023

Nr: 000-018

Ora: 11:28

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË MTSC.SHPK, PËR AKREDITIMIN E DISA VËZHguesVE PËR
VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 20.07.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: MTSC.shpk, me adresë në Tirane "Ish - Ndërmarrja Metalike" Tirana", (Reparti i Orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

V Ë R E J:

MTSC.shpk i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 6 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 01.05.2023.

MTSC.shpk, në respektim të nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqërues i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

V E N D O S A:

1. Akreditimin e 6 vëzhguesve të MTSC.shpk për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI